

VENDIM

Nr.134, date 7.3.2003

PER VERTETIMIN DHE LEGALIZIMIN E DOKUMENTEVE TE LESHUARA NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE, PER PERDORIM JAShte VENDIT DHE TE DOKUMENTEVE TE HUAJA, PER PERDORIM BRENDA VENDIT

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës, te nenit 23 te ligjit nr.8372, date 9.7.1998 "Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore" dhe te shkronjës "d" te nenit 6 te ligjit nr.8927, date 25.7.2002 "Për prefektin", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve te Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Vërtetimi i dokumenteve te lëshuara ne Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit, te behet:
 - a. institucionet e administratës publike, te nivelit qendror, qe me poshtë do te quhen "institucione qendrore", si për dokumentet e lëshuara nga vete ato dhe nga institucionet e varësisë ose institucionet e linjës;
 - b. institucionet e pavarura, për dokumentet e lëshuara nga administrata e tyre;
 - c. nga prefektët, për dokumentet e lëshuara nga njësitë e qeverisjes vendore. "Institucionet qendrore" dhe "institucione te pavarura", ne kuptim te këtij vendimi, janë institucionet e parashikuara ne nenin 2 te ligjit nr.8549, date 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".
2. Dokumentet e vërtetuara sipas pikës 1 te këtij vendimi, te lëshuara nga institucionet qendrore, institucionet e pavarura dhe prefektët, legalizohen nga nëpunësit konsullore, ne Ministrinë e Punëve te Jashtme dhe ne përfaqësitë e Republikës se Shqipërisë jashtë vendit.
3. Aktet e lëshuara nga noteri legalizohen drejtpërdrejtë nga nëpunësit konsullore.
4. Dokumentet e autoriteteve te huaja, qe do te përdorën brenda vendit, legalizohen ne përfaqësitë e Republikës se Shqipërisë jashtë vendit, ndërsa dokumentet e legalizuara nga përfaqësitë e akredituara ne Tirane, legalizohen ne Ministrinë e Punëve te Jashtme.
5. Ne vendet ku Republika e Shqipërisë nuk ka përfaqësi te akredituar, legalizimi i dokumenteve te huaja, te legalizuara me pare nga Ministria e Jashtme e vendit te origjinës, kryhet ne Ministrinë e Punëve te Jashtme.
6. Modeli i vërtetimit dhe legalizimit te dokumentit është sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr.2, qe i bashkëlidhen këtij vendimi. Ndryshimet e modeleve bëhen nga Ministri i Punëve te Jashtme, i cili njofton menjëherë institucionet qendrore, institucionet e pavarura dhe prefektët.
7. Titullarët e institucioneve qendrore, te institucioneve te pavarura dhe prefektët, brenda 15 ditëve nga hyrja ne fuqi e këtij vendimi, dërgojnë pranë Ministrisë se Punëve te Jashtme emrat e personave te ngarkuar, për vërtetimin dhe lëshimin e dokumenteve, si dhe depozitojnë specimenet e nënshkrimeve te tyre dhe gjurmët e vulave zyrtare.
8. Ne rast largimi te personave te përcaktuar sipas pikës se mësipërme, titullarët e institucioneve qendrore, te institucioneve te pavarura dhe prefektët njoftojnë menjëherë Ministrinë e Punëve te Jashtme dhe depozitojnë pranë saj nënshkrimet e personave zëvendësues.
9. Ministria e Drejtësisë njofton menjëherë Ministrinë e Punëve te Jashtme për emërimin ose largimin nga detyra te noterit dhe depoziton nënshkrimin dhe gjurmët e vulave te tij.
10. Ngarkohen institucionet qendrore, institucionet e pavarura dhe prefektët për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KR YEMINISTRI

Fatos Nano

Lidhja 1

Modeli i vërtetimit

(Institucioni i administratës publike/prefekti)

Nr. _____

Vërtetohet autenticiteti i nënshkrimit të znj./z

(Emri, mbiemri i nëpunësit lëshues)

me funksion

(funksioni zyrtar)

dhe vula zyrtare

(Emri, mbiemri i nëpunësit vërtetues)

(Nënshkrimi)

(Vendi), me (Data)

(Vula zyrtare e institucionit qendror)

Lidhja 2

Modeli i legalizimit

(Ministria e Punëve të Jashtme/Përfaqësia)

No. _____

Hereby is certified the authenticity of signing of
Mrs/Mr./

Vërtetohet autenticiteti i nënshkrimit të znj./z

(Emri, mbiemri i nëpunësit vërtetues)

in the capacity / me funksion

(funksioni zyrtar)

and the official seal / dhe vula zyrtare

(Emri, mbiemri i nëpunësit konsullor)

(Nënshkrimi),

(Vendi), (Data)

(Vula zyrtare)

(Ministria e Punëve të Jashtme/Përfaqësia) No.

Hereby is certified the authenticity of signing of Mrs/Mr./

Vërtetohet autenticiteti i nënshkrimit të znj./z

(Emri, mbiemri i nëpunësit vërtetues)

in the capacity / me funksion

(funksioni zyrtar)

and the official seal / dhe vula zyrtare

(Emri, mbiemri i nëpunësit konsullor)

(Nënshkrimi),

(Vendi), (Data)

(Vula zyrtare)